

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër dënuarit R.S., nga P., për shkak të veprave penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 të KPK dhe ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.4 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit R.S., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.454/2017 datë 30 tetor 2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11 prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit R.S., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.454/2017 datë 30 tetor 2017,dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prizren – DKR, P.nr.240/2015 datë 15.7.2016, i dënuari R.S., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.4 të KPK dhe për këtë vepër është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 6.9.2015 gjer më 25.11.2015 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 26.11.2015 gjer më 15.7.2016. I është shqiptuar edhe vendimi plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Me të njëjtin aktgjykim sipas pikës I të dispozitivit të aktgjykimit, është liruar nga akuza për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni378 par.9 lidhur me par. 6 të KPK. Është detyruar që të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 500 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas

plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës duke vendosur sipas ankesave të Prokurorit të Shtetit dhe mbrojtësit të të dënuarit me aktgjykimin PAKR.nr.454/2017 datë 30 tetor 2017, ka vendosur si në vijim:

“I. Me aprovimin e pjeshëm të ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit R.S., av. Ruzhdi Berisha dhe sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, P.nr.240/2015 datë 15.7.2016, vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprës penale ashtu që Gjykata e Apelit, gjen se në veprimet e të akuzuarit R.S. të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit nën pikën I dhe II ekzistojnë vetëm elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par. 6 të KPK, ndërsa dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh ia merr si të vërtetuar, duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës 6.9.2015 gjer më datë 25.11.2015 dhe në arrest shtëpiak prej datës 26.11.2015 e deri më datë 15.7.2016.

II. Ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren për pjesën liruese të aktgjykimit dhe vendimin mbi dënimin si dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit për bazat tjera, refuzohen si të pabazuara.

III. Ndërsa aprovohet ankesa e Prokurorisë sa i përket dënimit plotësues, ashtu që masa e ndalimit të drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, ndaj të akuzuarit rrjedhë pasi që i akuzuari e mban dënimin në tërësi.”

Kundër këtij aktgjykimi, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit Ruzhdi Berisha, avokat nga Prizreni, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë ose të ndryshohet përkitazi me vendimin për dënimin duke i shqiptuar një dënim më të butë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë me parashtresën KMLP.II.nr.234/2017 datë 19.12.2017, duke propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit potencon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale

nga neni 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par.3 të KPPK, sepse dispozitivi i tij është i paqartë dhe në kundërshtim me vetveten dhe shkresat e çështjes. Kështu në kërkesë theksohet se në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë sipas pikës I i dënuari është liruar nga akuza për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 të KPK, ndërsa sipas dispozitivit II është shpallur fajtor për veprën penale ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.5 të KPK. Gjykata e Apelit të Kosovës, sipas dispozitivit I aktgjykimin e shkallës së parë e ndryshon përkritazi me cilësimin juridik ashtu që të dënuarin e shpall fajtor për veprën penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 të KPK, për të cilën vepër ai ka qenë i liruar me aktgjykimin e shkallës së parë, ndërsa tani për këtë vepër dënimin e shqiptuar ia merr si të vërtetuar i cili është shqiptuar për një vepër tjetër penale. Paqartësia tjetër e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së dytë sipas pretendimeve të mbrojtësit të të dënuarit qëndron në atë se në dispozitivin e II të aktgjykimit konstatohet se ankesa e Prokurorit e paraqitur për pjesën liruese dhe për vendimin mbi dënimin refuzohen si të pabazuara, kështu ky dispozitiv është në kundërshtim me vetveten pra me dispozitivin I. të aktgjykimit, shkelje këto të cilat e bëjnë dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë plotësisht të paqartë dhe në kundërshtim me dispozitën e nenit 384 par.1 pika 1.12 e lidhur me nenin 370 par.3 të KPK. Po ashtu, theksohet se gjykata e shkallës së dytë në rivendosje ka pas detyrim në kuptim të nenit 440 par.2 të KPPK, të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës e cila gjykatë kishte anuluar aktgjykimin e shkallës së dytë sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, mirëpo kjo Gjykatë në rivendosje ka përsërit të njëjtat shkelje esenciale sikur në aktgjykimin e mëparshëm.

Gjykata Supreme, konstatoj se siç rezulton nga shkresat e çështjes, i dënuari R.S., me aktgjykimin e shkallës së parë sipas dispozitivit I. është liruar nga akuza për shkak të veprës penale rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par. 6 të KPK, ndërsa sipas pikës II. të dispozitivit, është shpallur fajtor për veprën penale ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par.4 të KPK.

Janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit se aktgjykimi i shkallës së dytë, pra dispozitivi i tij është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten. Nga aktgjykimi i shkallës së dytë rezulton se Gjykata e Apelit të Kosovës, në dispozitivin I të aktgjykimit konstaton se “me miratimin e ankesës së mbrojtësit të të dënuarit aktgjykimi i shkallës së parë ndryshohet përkritazi me cilësimin juridik ashtu që në dispozitiv të aktgjykimit nën pikën I dhe II ekzistojnë vetëm elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 të KPK”.

Kundërthënie tjetër e dispozitivit të aktgjykimit dhe arsyetimin konsiston në atë se deri sa në dispozitiv konstatohet “...ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore – DKR në Prizren, ... vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprës penale, ashtu që Gjykata e Apelit gjen se në veprimet e të akuzuarit R.S. të përshkruara në dispozitiv

të aktgjykimit nën pikën I dhe II ekzistojnë vetëm elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 të KPK...”, në dispozitivin II konstaton se ankesa e Prokurorit të Shtetit për pjesën liruese refuzohet si e pabazuar.

Ky konstatim është plotësisht i pakuptueshëm për faktin se siç rezulton nga shkresat e çështjes lidhur me pjesën liruese të aktgjykimit, mbrojtësi i të dënuarit nuk ka ushtruar ankesë ndërsa, gjykata nga ana tjetër sipas pikës II të këtij dispozitivi, ankesën e Prokurorit të Shtetit për pjesën liruese e ka refuzuar. Kështu gjykata nuk ka mundur ta bëjë ricilësimin e veprës penale nga pjesa liruese të aktgjykimit dhe njëherit të refuzoj ankesën e Prokurorit e cila është parashtruar pikërisht për këtë pjesë të aktgjykimit gjë që dispozitivin e tij e bënë kundërthënës, të pakuptueshëm dhe si të tillë juridikisht të paqëndrueshëm.

Vlen të theksohet se Gjkata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit R.S., me aktgjykimin Pml.nr.130/3017 datë 22.8.2017, ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë PAKR.nr.583/2016 datë 22.11.2016, për shkak të kundërthënies të lartcekura dhe ka vendosur që çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

Në procedurën e serishme, gjykata e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kundërshtuar, përsëri ka vendosur në mënyrë identike dhe kështu ka injoruar sugjerimet e kësaj Gjykate, të paraqitura në aktgjykimin e lartë cekur.

Kështu, nga aktgjykimi i kundërshtuar del se gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e kundërshtuar nuk ka evituar shkeljet e konstatuara nga kjo gjykatë dhe ka nxjerr një vendim identik me vendimin paraprak me të metat-shkeljet e njëjta esenciale të dispozitave të procedurës penale, prandaj u desh që edhe ky aktgjykim për të njëjtat arsye të anulohet.

Në rivendosje, gjykata e shkallës së dytë, duhet të evitojë kundërthëniet dhe paqartësitë e konstatuara më lart dhe të nxjerr një vendim të drejtë dhe bazuar në ligj, duke pasur parasysh edhe pretendimet tjera nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.348/2017, më 11 prill 2018

Procesmbajtësja
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta